


Përgjegjësit për COVID-in – çfarë duhet të dini



Disa biznese duhet të emërojnë dhe mbështesin Përgjegjësit për COVID-in.

- Punëdhënësit duhet të mbajnë të dhënat e regjistrimit të shërbimeve të Përgjegjësit për COVID-in.
- Përgjegjësit për COVID-in mbështesin përputhshmërinë e vendndodhjes dhe ofrojnë këshillim mbi distancimin fizik, higjienën dhe praktikën e mbajtjes së të dhënave, në përputhje me kërkesat e COVIDSafe Plans dhe COVIDSafe Plans me Rrezik të Lartë.
- Idealisht, Përgjegjësit për COVID-in duhet të reflektojnë larminë në vendin e punës.

Cilat janë përgjegjësitë e Përgjegjësit për COVID-in?

Një Përgjegjës për COVID-in monitoron përputhshmërinë me COVIDSafe Plans dhe COVIDSafe Plans me Rrezik të Lartë.

Përgjegjësit për COVID-in ofrojnë këshillim për:

- masat e distancimit fizik
- masat e higjienës
- sigurimin e ajrosjes së duhur
- mbajtjen e të dhënave të sakta dhe të konsiderueshme (të cilat mund të auditohen)
- përditësimin e COVIDSafe Plans kur është e nevojshme

Çfarë informacioni tjetër është i rëndësishëm?

Përgjegjësit për COVID-in duhet të kalojnë një [trajnim themelor për njohuritë mbi kontrollin e infeksionit](#). Ju mund t'a gjeni këtë trajnim në [faqen e Trajnimit të Kontrollit të Infeksionit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë](#) ose [faqen e internetit Skills Victoria](#). Rekomandohet që Përgjegjësit për COVID-in janë trajnuar për ndihmën e shpejtë (Niveli 2).

Duhet të ketë një Përgjegjës për COVID-in në ambientet e punës sa here që punonjësit janë në vendin e punës (përjashtuar ambientet e shitjes me pakicë të një supermarketi). Rekomandohet që një Përgjegjës i emëruar për COVID-in të kalojë të paktën 50 për qind të kohës së tij/saj të punës për përmbushjen e detyrave të Përgjegjësit. Punonjësit mund të emërojnë disa Përgjegjës për COVID-in nëse është e nevojshme.

Emërimet duhet të kryhen duke u këshilluar me Përfaqësuesit e Shëndetit dhe Sigurisë dhe punonjësit.

Përgjegjësit për COVID-in nuk duhet të diskriminohen ose të jenë objekt i ndonjë veprimi kundër tyre për moskryerjen e detyrave të tyre.

Mbani mend se punëdhënësi ka përgjegjësinë përfundimtare për të siguruar përmbushjen e detyrimeve COVIDSafe.

Nëse dyshoni se ju, stafi juaj ose një klient keni koronavirus (COVID-19) telefononi në linjën e posaçme telefonike të pandërprerë për koronavirusin te 1800 675 398